

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr 215/2 prot

Gramsh, më 21 /01 /2026

VENDIM
Nr.2, Datë 21.01.2026

Për

Miratimin e kërkesave për bonus të qirasë për dy familje në nevojë ,bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore.

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 21.01.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e Sektori I Emergjencave Civile dhe Strehimit "Për miratimin e kërkesave për bonus të qirasë për disa familje në nevojë , bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore", në mbështetje të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 "Për strehimin social", në VKM nr.459, datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirës ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin", në Udhëzimin e MFE, nr.31, dt.18.11.2019, "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2;

Vendosi:

- I. Të miratohet kërkesa për 2 familje në nevojë për bonus të qirasë , bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore.
- II. T'i propozohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit alokimi i fondeve në shumën 192 000 (një qind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë sipas tabelës bashkëlidhur.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë, Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit, drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulja GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI

